

# Raport përmbledhës mbi pyetëtorin

*“Formular vlerësimi nga  
personeli akademik”*

**Viti akademik**

**2020-2021**

---

**Njësia e Sigurimit të Cilësisë  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**





# Lista e shkurtesave

**FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

**NJSC - Njësia e Sigurimit të Cilësisë**

**IAL - Institucion i Arsimit të Lartë**

## Hyrje

Në zbatim të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë dhe të Paketës së Instrumentave të Cilësisë në UT, grupi i punës ndërtoi një pyetësor (*Shtojca Nr.1*), të miratuar më pas si të tillë në mbledhje Dekanati, më 12.04.2021.

Zyra IT e FGJH-së u kujdes për shpërndarjen e tij elektronike nëpërmjet platformës TEAMS (forms) tek personeli akademik i Fakultetit tonë. Ky pyetësor plotësohet çdo vit nga personeli akademik. Përpunimi i të dhënave të marra pas shpërndarjes së pyetësorit u krye nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë të FGJH-s.

## Përmbajtja e pyetësorit

Pyetësori “*Formulari i vlerësimit nga personeli akademik*” përbëhet nga 20 seksione

1. Departamenti (ku tregohet numri i personelit akademik që ka plotësuar pyetësorin)
2. Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet.
3. Stimulimi intelektual në punë
4. Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht
5. Ndërveprimi me studentët
6. Bashkëpunimi me kolegët
7. Këshillimi që keni në dispozicion
8. Mbështetja administrative që merrni nga departamenti
9. Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik
10. Perspektivat tuaja për avancim dhe progres në karrierë
11. Paga
12. Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament
13. Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj
14. Atmosfera e përgjithshme në departament
15. Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja
16. Cilët janë aktualisht faktorët kryesorë që ju motivojnë dhe ju falin kënaqësi në punë
17. Përmendi disa faktorë që mund të përmirësojnë motivimin tuaj në punë
18. Të dhëna si anëtar fakulteti (titulli akademik)
19. Të dhëna si anëtar fakulteti (grada shkencore)
20. Të dhëna si anëtar fakulteti (vitet e punës)

## Gjetjet e pyetësorit

Personeli akademik duhet të rrethonte nga pyetja 2 – 15 gërmat nga A në E ku vlerësimi me A është shkalla më e lartë (shumë i kënaqur) dhe me E shkalla me e ulët (shumë i pakënaqur) dhe pika C nuk e di (në rast mosnjohje). Pyetjet 16, 17 janë pyetje të lira pa vlerësim ku pedagogu jep mendimin e tij personal. Pyetjet 18-20 i referohen të dhënave në lidhje me personelin akademik.

Më poshtë, po sjellim disa analiza të përfuara sipas seksioneve, të dhënave të gjeneruara nga “*Formulari i vlerësimit nga Personeli akademik*”.

Pas gjenerimit automatik të dhënave (Shtojca Nr.2) rezultoi se nga numri total i Personelit Akademik pjesëmarrës në pyetësor është 73 kur në total janë 129, pra 56,56 % e tij.

## 1. Departamenti

Personeli Akademik që plotësoi pyetësorin nga secili departament është si më poshtë:

- Departamenti i Gjuhës Angleze 26 ose 55,3 % e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhës Gjermane 11 ose 68,75% e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhës Frënge 14 ose 70% e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhës Italiane 12 ose 57,1% e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhës Spanjolle 2 ose 25% e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhës Greke 3 ose 42,8% e personelit akademik
- Departamenti i Gjuhëve Sllave-Balkanike 5 ose 50% e personelit akademik

Vlerësojmë se përqindjet e mësipërme janë në përputhje proporcionale me përpjesëtimin e personelit akademik për departamentin përkatës.

Pyetje	Shumë i kenaqur	I kënaqur	Nuk ka dijëni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet	19,2%	42,4%	27,4%	9,6%	1,4%
Stimulimi intelektual në punë	17,8 %	52 %	9,6 %	17,8 %	2,7 %
Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht	35,6 %	43,3 %	9,2 %	6,8 %	0 %
Ndërveprimi me studentët	49,3 %	39,7 %	8,2 %	2,7 %	0 %
Bashkëpunimi me kolegët	42,5 %	41 %	4,1 %	10,95 %	1,4 %
Këshillimi që keni në dispozicion	16,7 %	46,6 %	21,9 %	11 %	4,1 %
Mbështetja administrative që merrni nga departamenti	47,9 %	39,7 %	5,5 %	5,5 %	1,4 %
Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik	28,8 %	39,7 %	16,4 %	9,6 %	5,5 %
Perspektivat tuaja për avancim dhe progres në karrierë	26 %	41 %	17,8 %	9,6 %	5,5 %
Paga	4,2 %	9,2 %	11 %	38,4 %	27,4 %
Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament	28,8 %	53,4 %	12,3 %	1,4 %	4,1 %
Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj	4,1 %	49,3 %	15 %	20,5 %	9,6 %
Atmosfera e përgjithshme në departament	23,3 %	52 %	8,2 %	9,6 %	6,8 %
Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja	24,7 %	42,5 %	17,8 %	6,8 %	8,2 %

## REKOMANDIME

1. Të bëhen përpjekje nga IAL, për një pjesëmarrje më aktive të personelit akademik në plotësimin e pyetësorëve pasi kjo i vjen në ndihmë jo vetëm institucionit për të evidentuar problematikat por edhe për të dëgjuar zërin e personelit të tij mbi shqetësimet që ata përcjellin me qëllim zgjidhjen sa më të shpejtë të mundshme të tyre.
2. T'i mundësohet personelit akademik përditësimi me informacionin e duhur në këtë aspekt.
3. Të bëhen përpjekjet maksimale në këtë drejtim pasi nxitja intelektuale ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe në rritjen në karrierë akademike.
4. Duke i referuar situatës aktuale pandemike ku personeli u gjend përballë sfidave të reja dhe shpesh të vështira për t'u kapërcyer është e nevojshme që të bëhen përpjekje qartësuese dhe përditësuese dhe trajnuese për personelit akademik pasi referuar përgjigjeve rezultojnë që ka nevojë të qartësohet e përditësohet e trajnohet vazhdimisht mbi avantazhet apo dizavantazhet e llojit të mësimdhënies dhe kërkimit që zhvillon aktualisht si dhe me qëllim zgjidhjen e problematikave që has gjatë punës së tij si dhe me qëllim që të drejtojë fokusin ashtu siç duhet në lidhje me këto aspekte.
5. Duke pasur parasysh llojin e mësimdhënies aktuale të bëhen përpjekje që mësimi virtual të bëhet sa më atraktiv dhe më ndërveprues në mënyrë të tillë që bashkëveprimi të jetë në rend të ditës duke synuar në praninë e një studenti që reagon dhe jo që qëndron pasiv pas ekranit të kompjuterit.
6. Të bëhen përpjekje si në rang departamenti ashtu edhe në rang IAL për një frymë bashkëpunimi më të mirë ndërmjet kolegësh, pasi kjo padyshim sjell rritjen e cilësisë jo vetëm në mësimdhënie por në të gjithë sektorët që përfshin ky profesion. Kjo mundësohet me anë të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të personelit si në grupe pune, komisione, projekte, hartime planesh etj.
7. Të ofrohen forma mbështetëse këshilluese të cilat ndihmojnë personelin akademik në zgjidhjen e problematikave të ndryshme, në kërkimin shkencor, dhe në rritjen në karrierë.
8. Të bëhen përpjekje për një mbështetje administrative më efektive dhe më frytdhënëse për personelin për zgjidhjen e problematikave të hasura në lidhje me këtë aspekt.
9. Është e nevojshme të bëhen përpjekjeje për një nxitje më të madhe e të vazhdueshme me qëllim motivimin e personelit akademik për zhvillimin të mëtejshëm të tyre në karrierë duke u krijuar atyre hapësira të tilla që ua mundësojnë këtë progres.
10. Duke iu referuar gjenerimit të të dhënave, të bëhen përpjekje për rritjen e pagës së personelit akademik si një aspekt mjaft i rëndësishëm dhe nxitës për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës akademike.
11. Të ofrohen forma mbështetëse këshilluese dhe takime për të siguruar maksimalisht rehatinë psikologjike të personelit akademik, në mënyrë që ata të ndihen edhe më të sigurtë.
12. Lidhur me këtë pikë të krijohen më shumë mundësi nga departamenti për të promovuar përvojën dhe njohuritë e personelit akademik. Në këtë mënyrë arrihet dhe rritja e cilësisë së individit por edhe njësisë bazë.

Hartoi NJSBC në FGJH